



Prishtinë: 02.09.2021
Kodi i ZRRE-së: V_1389_2021

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_1891_11_18 i dt. 30.11.2018**;
- Ankesën e konsumatorit;

në seancën e mbajtur më datë 02.09.2021 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit N.S, nga Komuna e Mitrovicës, si e pabazuar.
- II. **MBETET në fuqi**, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRrE/DMK_V_1891_11_18, i datës 30.11.2018.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtje të Konsumatorëve në ZRrE me datë 30.11.2018 ka marrë vendim me nr. ZRrE/DMK_V_1891_11_18 me të cilin e ka refuzuar ankesën e konsumatorit N.S nga Komuna e Mitrovicës lidhur me kontestimin e faturave për shkak të matjes jo të saktë të njehsorit elektrik nr. 35716532.

I pakënaqur me vendimin e DMK-së, konsumatori N.S, brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së, për këto shkaqe:

- Dyshimet për saktësinë e matjes së njehsorit kanë qenë se shpenzimi i transmetuesit të radios ka qenë konstant dhe njehsori kontestues ka treguar 2-3 fish më shumë shpenzim të kilovatëve, se njehsori i vjetër është ndërruar pa arsye dhe se KESCO nuk është marrë me ankesën e konsumatorit para se t'i drejtohen ZRRE-së.
- Kanë kërkuar që si mesatare të shpenzimit të energjisë elektrike të merret periodha 07/2008 – 07/2013.
- Periodha e konsideruar nga DMK për analizë të rrjedhës së energjisë elektrike 09/2016 – 09/2018, është periodha kur është ndërruar transmetuesi i vjetër me 1 kW me transmetuesin e ri me 2 kW, e që rrjedhimisht shpenzimi ishte dyfishuar.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 02.09.2021 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për



Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Lidhur me pretendimin e konsumatorit se njehsori kontestues ka treguar 2-3 fish më shumë shpenzim të energjisë elektrike dhe se njehsori i vjetër është ndërruar pa arsye, Bordi e vlerëson si të paqëndrueshëm dhe të pa bazë, për faktin se bazuar në shqyrtimet e bëra si në shkresat e lëndës, është konstatuar se nuk është evidentuar ndonjë çrregullim i pikës matëse, përkatësisht nuk janë evidentuar gabime në sistemet matëse. Sipas shpenzimeve të evidentuara në procesverbalin e inspektimit, është konstatuar se shpenzimet e konsumatorit të evidentuara në CCP për periudhën 01/2015, përputhen me gjendjen e evidentuar në procesverbalin e inspektimit. Po ashtu, duke u bazuar në procesverbalin mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik të dt.05.10.2016 është konstatuar se shpenzimet e konsumatorit të evidentuara në CCP për periudhën 09/2016 përputhen me gjendjen e evidentuar në procesverbal.

Bordi po ashtu ka analizuar edhe protokollin mbi shqyrtimin e njehsorit elektrik të dt.07.07.2017, ku ndër të tjera është evidentuar si vërejtje që njehsori elektrik nuk ndizet, e si pasojë, njehsori elektrik nuk ka mundur që të shqyrtohet për saktësi të matjes. Andaj, edhe pretendimi i lartshënuar, si i tillë nuk ka mbështetje faktike.

Me qëllim që të kemi një pasqyrë të qartë të profilit të konsumatorit, Bordi ka analizuar rrjedhën e energjisë elektrike dhe ka konstatuar se konsumatori ka lexim dhe faturim të rregullt të shpenzimeve mujore. Sipas analizës së rrjedhës së energjisë elektrike për periudhat kontestuese me njehsorin e vjetër elektrik-kontestues nr.35716532 dhe njehsorin e ri elektrik nr.32629498 për periudha të njëjta kohore, Bordi ka konstatuar se konsumatori ka ndryshim të shpenzimeve të energjisë elektrike dhe me qëllim që të paraqiten sa më qartë shpenzimet e konsumatorit ka bërë analizimin e konsumit të energjisë së konsumatorit, për periudha të njëjta kohore: me njehsorin e vjetër elektrik nr.35716532 periudha 10/2014 deri në periudhën 09/2016 mesatarja mujore e shpenzimit është **2,093kWh/muaj**, kurse me njehsorin e ri elektrik nr.32629498 për periudhën 10/2016 deri në periudhën 09/2018 mesatarja mujore e shpenzimit është **2,466 kWh/muaj**.

Bazuar analizat e bëra vërtetohet se konsumatori për periudhën e njëjtë me njehsorin e ri elektrik nr. 32629498 ka rritje prej **18%** krahasuar me shpenzimet në njehsorin kontestues nr.35716532, por që **kjo nuk paraqet ndonjë rritje të madhe** të shpenzimit të energjisë elektrike e cila do të duhet të veçohet. Andaj, edhe pretendimi se shpenzimi ishte dyfishuar nuk qëndron, pasi që siç edhe mund të shihet nga shkresat e lëndës, rritja e shpenzimit të energjisë elektrike me njehsorin e ri elektrik është 18%.

Bordi i ZRrE-së bazuar në transaksionet e konsumatorit dhe rrjedhën e energjisë elektrike konstaton se KEDS/KESCO kanë respektuar nenin 28 par. 1 dhe 2 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, ku thuhet se: *"1. Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shfrytëzuar dhe për taksat e tjera, në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me konsumatorin (nëse është e aplikueshme). 2. Faturimi i energjisë së shpenzuar të zbatohet për cdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Furnizuesi ose Operatori i Sistemit për konsumatorët me tarifa të rregulluara në bazë*



të tarifave të miratuara nga ZRRE-ja dhe për konsumatorët e kualifikuar (me cmime të parregulluara), ashtu sic është rënë dakord në kontratën për furnizim”.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar argumente të qëndrueshme dhe prova tjera.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 02.09.2021 pas analizimit të gjithë asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Lutfije Dervishi, anëtare

Gani Buçaj, anëtar

Vendimi u dërgohet:

- KESCO-së,
- Konsumatorit N.S dhe
- Arkivit të ZRRE-së.